



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:149420

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812874

CT.nr.08/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN–Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, duke vendosur në procedurën jokontestimore, lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë pas vdekjes së të ndjerës Z.B nga Gjilani, në procedurën e iniciuar nga propozuesja T.K nga Gjilani, Rr.”...”, nr.24, me propozimin për shqyrtimin e pasurisë së gjetur më vonë, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike, me datë 10.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. VËRTETOHET se e ndjera Z.B ish amvise nga Gjilani, ka lindur në vitin 1902, ndërsa ka vdekur në Gjilan më datën 15.08.1975.

II. Nga pasuria trashëgimore përveç pasurisë së shqyrtuar sipas Aktvendimit të ish- Gjykatës Komunale në Gjilan, T.nr.39/2003, është gjetur edhe pasuria e paluajtshme edhe ate njësia kadastrale P-70403013-00308-3 në vendin e quajtur “Lokva”, në sipërfaqe prej 137 m2 e cila në DGJKP në Gjilan evidentohet sipas Certifikatës së pronës me numër të lëndës 49803 të datës 14.05.2024 në emër të Z.B e veja e H... ish nga Gjilani.

III. E ndjera pas vdekjes së saj, për trashëgimtarë të rendit të parë ligjor kishte lënë: vajzën T.K nga Gjilani.

IV. Për trashëgimtar të vetëm ligjor të kësaj pasurie të gjetur më vonë, **SHPALLET** vajza T.K nga Gjilani.

V. Shpenzimet e procedurës në lartësi prej 60,00 euro, i bart propozuesja.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë me dt.24.05.2024 propozuesja T.K nga Gjilani, ka paraqitur propozim për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të gjetur më vonë, pas vdekjes së të ndjerës Z.Bish nga Gjilani.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka caktuar seancë për datën 10.06.2024, ku në këtë seancë gjykata ka konstatuar se e ndjera Z.B ish nga Gjilani, ka lindur në vitin 1902, ndërsa ka vdekur më datën 15.08.1975 në Gjilan, dhe për të ndjerën është zhvilluar procedura trashëgimore dhe është shpallur trashëgimtarja T.K

Nga pasuria trashëgimore, përveq pasurisë së shqyrtuar sipas Aktvendimit të ish - Gjykatës Komunale në Gjilan T.nr.39/2023 të dt.21.03.2003, është gjetur edhe pasuria e paluajtshme, përkatësisht njësia kadastrale P-70403013-00308-3 në vendin e quajtur “Lokva”, në sipërfaqe prej 137 m², e cila në DGJKP në Gjilan evidentohet sipas Certifikatës së pronës me numër të lëndës 49803 të datës 14.05.2024 në emër të Z.B e veja e H...t ish nga Gjilani, dhe në kohën e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore, për këtë pasuri të paluajtshme, trashëgimtarja ligjore nuk ka pasur njohuri se ekziston.

E ndjera për trashëgimtarë të rendit të parë ligjor kishte lënë vajzën T.K nga Gjilani.

Nga pasuria trashëgimore ka mbetur pasuria e paluajtshme e cekur në pikën I të këtij dispozitiv e vlerësuar sipas dëshmisë së aktvdekjes së atëhershme e datës 27.02.2003..

Propozuesja T.K ka deklaruar se e pranon pasurinë trashëgimore të gjetur më vonë, konform certifikatës pronësore për parcelën nr.308-3, si pasuri e gjetur më vonë dhe deklaron se trashëgimtar të tjerë të ndjerës Z.B nuk ka pos saj si vajzë e saj.

Gjykata i ka administruar provat materiale siç janë: Aktvendimi i trashëgimisë T.nr.39.2003 lëshuar nga ish Gjykata Komunale në Gjilan, Aktvdekja e përpiluar në Gjilan, më datën 27.02.2023, për të ndjerën Z.B dhe trashëgimtare ligjore T.K Raporti për vlerësimin e paluajtshmërive, i datës 24.05.2024, lëshuar nga DGJKP në Gjilan, ku vlera e pasurisë së gjetur më vonë është vlerësuar në shumë prej 9,000.00 euro, certifikatën pronësore me numër të lëndës 4890-3 të datës 14.05.2004, që ka të bëjë me njësinë kadastrale nr.308-3 në sipërfaqe prej 137 m².

Nga të lartcekurat, gjykata për trashëgimtarë të pasurisë së cekur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi në bazë të Ligjit mbi Trashëgimin të Kosovës shpalli trashëgimtare T.K nga Gjilani, e cila është person i njëjte me personin T.K

Andaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 9, 11 të Ligjit mbi Trashëgimin të Republikës së Kosovës, nenit 171, 164.4 dhe 182.1 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore të Republikës së Kosovës.

**Gjyqtari
Berat Spahiu**

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes kësaj gjykate.